

Debat publik në Dibër

Më 4 dhjetor të vitit 2007 në Dibër u mbajt debat publik në temë “Gjendja me mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë në Dibër dhe Qendër Zhupë”.

Në debat morën pjesë 46 pjesëmarrës edhe atë: përfaqësues nga vetëqeverisja lokale dhe institucionet lokale nga Dibra dhe Qendra e Zhupës (11), përfaqësues nga organizata joqeveritare nga Dibra, Qendra e Zhupës, Mavrova dhe Rostusha (31) dhe përfaqësues të mediemeve lokale dhe nacionale (4).

Qëllimi i debatit ishte të diskutohet për gjendjen me mbrojtjen e të drejtave të bashkësive etnike jo shumicë në rajon dhe të shqyrtohen mundësitë për avancimin e statusit të tyre.

Debatin e facilitoi Goce Ljubinovski nga Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësisë nga Dibra, i cili e hapi ngjarjen me një prezantim të shkurtë të projektit. Në debat qëndrimet e veta i shprehën: Kamer Imeri, këshilltar shtetëror në zyrën rajonale të Avokatit të Popullit në Kërçovë, Nizamedin Papraniku, kryetar i Këshillit të komunës së Dibrës, Iliri Iseni, përfaqësues nga OJQ “Rinia tolerante” nga Dibra, Ivanka Ivanovska, përfaqësuese e Organizatës së grave nga Dibra dhe Fehmi Skender, përfaqësues i OJQ-s “Zhupa Turkleri” nga Qendra e Zhupës.

Në debat u diskutua për përfaqësimin e pamjaftueshëm të bashkësive etnike jo shumicë në institucione, zbatimi i dygjuhësisë në nivel lokal, organizimi i Verës kulturore dibrane 2007 nga aspekti i përfshirjes të gjitha bashkësive etnike dhe respektimi i principit të dygjuhësisë.

Në diskutim u kyçën numër i madh i pjesëmarrësve duke u pajtuar se në Dibër ekziston respekt i ndërsjellë dhe jetohet në një frymë multietnike. Vetëqeverisja lokale, institucionet lokale dhe organizatat joqeveritare janë të hapura dhe të gatshme për të punuar në drejtim të avancimit të drejtave të bashkësive jo shumicë në nivel lokal, por ka hapësirë për përmirësimin e gjendjes në disa lëmi. U rekomandua që të organizohen takime të ngjashme edhe në komunat tjera, të formohen partneritete dhe koalicione që në të ardhmen të zgjidhen problemet aktuale. Në këtë mënyrë mundet të zgjidhet problemi me përfaqësimin e barabartë etnik në aktivitetet kulturore, respektimin dhe përdorimin e dygjuhësisë në gjitha sferat e jetesës lokale dhe përmirësimin e komunikimit mes pushtetit qendror dhe atij lokal me qëllim të zhvillimit më të mirë të rajonit. Nga debati doli edhe konkludimi se duhet të ndërmerren masa për aktivizimin e Komisioneve për marrëdhënie mes bashkësive në Dibër dhe Qendrën e Zhupës.

Inserte televizive nga ky debat u emituan në televizionin lokal TV Zhupa. Debatin e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrën lokale të projektit në Dibër (Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësisë në Dibër, ish Qendra për përkrahje të OJQ-ve Dibër).